



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.29.08.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin:** Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Nazlije Shala dhe Bajram Hashani

**Të pranishmit tjerë:** drejtorët komunal, Burim Gërguri, shef i kabinet të Kryetarit të Komunës

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Dhënia në debat publik e Draft Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimi dhe mirëmbajtja e tyre
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

#### **Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

#### **Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 5 vota për dhe 2 vota kundër.

#### **Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Hap debatin për dhënien në debat publik të Draft Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

**Enver Gashi** – Ne e kemi lexuar këtë Draft Rregullore, por kontributi ynë do të jetë në mbledhjen e Kuvendit, prandaj ne jemi për atë që kjo Draft Rregullore ti rekomandohet Kuvendit.

**Sami Ahmeti** – Edhe ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditë të shkoj në Kuvend dhe pastaj për debat publik gjithsesi se jemi.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal dhënien në debat publik të Draft Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se e kemi një kërkesë emergjente, nga DEFZH-ja, të cilën e kemi pranuar tash para fillimit të mbledhjes, që është për transfer të mjeteve dhe nga Drejtoria në fjalë kërkohet që të futet në rend dite.

**Enver Gashi** – Këtë kërkesë meqenëse, drejtoresha e ka arsyetue ne e rekomandojmë për Kuvend dhe atje e jepim kontributin secili, por drejtoresha duhet të jetë gjithsesi.

**Sami Ahmeti** – Realisht një kërkesë me gjithë këto mjete me ardhë vetëm në momentin e fundit, mua më duket tendencioze. Nuk është që i paraprijmë dhe mendojmë se gjithçka është zi, por këtu janë bukur shumë mjete dhe me thënë se ka ardhë urgjente, pse bash sot urgjente, pse ne nuk i kemi këto të dhëna më heret në mënyrë që edhe ne ta jepim kontributin tonë. Realisht unë e shohë tendencioze dhe ne jemi kundër që kjo pikë e rendit të ditës të bisedohet në këtë seancë, por në seancën e ardhshme, jo për diçka tjetër por që materialin nuk e kemi me kohë, aq më tepër drejtoresha nuk ka gjetë mundësi me ardhë dhe me na dhënë një shpjegim.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit komunal që të futet në rend dite kërkesa e DEFZH-së, për transfer të mjeteve.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Sami Ahmeti** – Kemi kërkesa në drejtim të DPUKP-së dhe Drejtorisë së Arsimit. Sa i përket DPUKP-së, kemi kërkesa që të dijme bazën ligjore, ose lejet që i kanë subjektet afariste Alkobetoni, Terrastone, Baza e asfaltit në Milloshevë dhe Apollonia. Në muajin e fundit kemi pasë shumë kërkesa dhe ankesa të qytetarëve për ndotjen enorme që e bëjnë këto subjekte dhe ne nuk duam asgjë tjetër, duam vetëm që të kemi për këto subjekte çfarë leje kanë, çfarë aktiviteti zhvillojnë ato në mënyrë që ta dijme se a mundemi me iu ndihmue atyre qytetarëve në këtë Kuvend, apo jo. Pastaj te Drejtoria e Arsimit vetëm kemi kërkesë për rraport të përgatitjeve për fillimin e vitit shkollor si është gjendja dhe gjithashtu, a janë siguruar mjetet, ose lëndët djegëse për vitin shkollor 2022-2023.

**Kryesuesja** – Pyetjet e juaja z.Ahmeti, do ti adresojmë te Drejtoritë përkatëse të cilat pastaj do të jepen sqarim në Kuvend.

**Mbledhja përfundoi në ora 10:13'**

**Bashk.prof.për punë të KK**

**Azize Zeneli**

